



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 71

Prishtinë, më 17.6.2016, në orën 16:20

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Donika Kadaj-Bujupi

Nga stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, Nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Kryesuesja, tha se arsyeja e thirrjes së kësaj mbledhjeje, ka të bëjë me faktin se amendamentet e propozuara në takimin që patëm më herët, duhet të hiqen, sepse janë të panevojshme dhe në substancë nuk e prekin përmbajtjen e ligjit. Ajo propozoi që të mbetet vetëm një amendament, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 10 i projektligjit, në rreshtin e pestë, fjalët: “*Presidenti i Dhomës*”, zëvendësohen me “*Kryetari i Dhomës*”, dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Të miratohet Projektligji nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, me amendamentin e propozuar.*
- II. I rekomandohet Zyrës për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor, që teksti në gjuhën serbe dhe angleze, të harmonizohet me tekstin në gjuhën shqipe.*

Mbledhja përfundoi në orën 16:25.
E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,
Selvije Halimi
